

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Indeksi / Izhazje / Date / Vendi: 071051 2025		
Nr. Orgv. Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 103	Nr. Faqeve. Br. Strana: 4
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
 KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
 MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
 E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Kalendari i Takimeve Publike për Buxhetimin me Pjesëmarrje

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, në koordinim me drejtorët e drejtorive komunale, Njësinë për Komunikim me Publikun dhe zyrtarë të tjerë komunalë, publikon kalendarin për organizimin e takimeve publike me qytetarë, në kuadër të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.

Kalendari i Takimeve Publike për Buxhetimin me Pjesëmarrje në Komunën e Ferizajt

Në takimin e parë qytetarët paraqesin propozimet e tyre për projekte, ndërsa në takimin e dytë zhvillohet votimi për projektet e përzgjedhura. Projekti që merr më së shumti vota nga qytetarët, kalon në fazën e përfshirjes në buxhetin e vitit 2026.

- Procesverbal -

Në shkollën fillore të mesme të ulët "Visar Dodani" është mbajtur takimi publik për buxhetimin me pjesëmarrje.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Në këtë takim morën pjesë:

- Meriton Hajdini, Drejtor i Infrastrukturës,
- Shyhrete Topalli-Rexhepi, Udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun,
- Ganimete Shehaj, Kryesuese e Komisionit për Buxhetim me Pjesëmarrje,
- Xhelal Topalli, Anëtar i Komisionit.

Në hapje të takimit, drejtori Hajdini informoi banorët se, në kuadër të këtij procesi, 1% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale është ndarë për një projekt që do të përzgjidhet nga vetë banorët. Gjatë takimit të hapur, qytetarët kishin mundësinë të paraqesin idetë e tyre, të diskutojnë nevojat e komunitetit dhe të votojnë për projektin me prioritet më të lartë.

Drejtori Hajdini e vlerësoi këtë proces si jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe të domosdoshëm, duke theksuar se përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje rrit transparencën dhe garanton që investimet të reflektojnë nevojat reale të komunitetit.

"Kur qytetarët janë pjesë e planifikimit, projekti merr kuptim dhe jetë," – u shpreh Hajdini gjatë takimit me banorët e fshatit Varosh.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Ky është një hap konkret drejt transparencës, përfshirjes qytetare dhe fuqizimit të komuniteteve lokale në planifikimin dhe përdorimin e buxhetit publik.

Kërkesat e banorëve:

Visar Heda, kryetar i fshatit Varosh, falënderoi Komunën e Ferizajt për investimet e deritanishme dhe paraqiti kërkesat e fshatit në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje:

1. Renovimi i shkollës "Visar Dodani"
2. Rregullimi i kanalizimit të shkollës
3. Ndërtimi i fushave sportive në lagjet "Musa" dhe "Tafa"
4. Rregullimi i parkingut pranë xhamisë së fshatit

Xhevdet Shabani falënderoi komunën për organizimin e këtyre takimeve, duke i cilësuar ato si shumë të rëndësishme për banorët e fshatit Varosh.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Habib Korsa propozoi që i gjithë buxheti i ndarë për këtë fshat të investohet në lagjen "Musa" për rregullimin e fushës sportive, duke e cilësuar këtë si një investim të qëlluar dhe të nevojshëm.

Fitim Musa propozoi ndërtimin e një kabineti për shkollën "Visar Dodani" si dhe ndërtimin e rrethojës së shkollës.

Edhe shumë banorë të tjerë mbështetën këto propozime.

Takimi përfundoi me këto propozime, të cilat do të votohen nga banorët më datë 29.04.2024.

Takimi u mbyll në orën 19:00.

Procesmbajtës:

Xhelal Topalli